



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

REFERENCE:	
DATE:	26.02.2026
PËR/ZA/TO:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit
PËRMES/PREKO/THROUGH	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshme në MAPL
CC	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së
NGA/OD/FROM:	Drin Haraçia, Drejtor i Departamentit për Mbikëqymje dhe Përfomancë Lokale Kujtim Aliu, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Legjislacionit Lokal Nehat Uka, Zyrtar i Lartë për Monitorim të Legjislacionit Lokal
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shkresë ligjore lidhur me mbajtjen e mbledhjes së rregullt të Kuvendit të Komunës

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ka monitoruar mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Lipjanit, e mbajtur me datë, 12.02.2026. Gjatë monitorimit të mbledhjes është konstatuar se rendi i ditës nuk u miratua dhe si rezultat i kësaj kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Lipjanit ka deklaruar se mbyllet mbledhja.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, bazuar në mandatin e saj ligjor të përcaktuar në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Rregullorja (QRK) - Nr.04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, konstaton se:

- Gjatë mbledhjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, e mbajtur me datë, 12.02.2026, kryesuesi i kuvendit, ka shpallur rezultatin e votimit për aprovimin e rendin e ditës, (14 vota për dhe 15 kundër) duke konstatuar se nuk miratohet rendi i ditës. Pas kësaj, kryesuesi ka shpallur mbylljen e mbledhjes si rezultat i mos miratimit të rendit të ditës.
- Bazuar në legjislacionin përkatës, mbledhja e kuvendit të komunës, konsiderohet e përfunduar në momentin kur kryesuesi i kuvendit të komunës ka konstatuar se e mbyll mbledhjen.

MAPL, konstaton se pasi mbledhja ishte shpallur e mbyllur, çdo akt i marrë pas këtij momenti është i pavlefshëm dhe nuk mund prodhojë efekt juridik e po ashtu mbledhja e mbyllur nuk mund të vazhdohet, pa ndjekur procedurat ligjore për thirrjen e mbledhjes së radhës.

Shpallja e mbledhjes e mbyllur e bënë të pavlefshëm çdo veprim pas atij momenti. Aktet e miratuara pas mbledhja paraprakisht është shpallur e mbyllur, nuk kanë efekt juridik, pasi që mbledhja ishte e përfunduar.

Bazuar në atë që u tha më lartë MAPL-ja, kërkon nga organet e komunës së Lipjanit që të ndërmarrin veprimet konkrete për anulimin e mbledhjes së kuvendit të komunës dhe sipas dispozitave ligjore, të përcaktuar me legjislacioni e aplikueshëm në Republikën e Kosovës të kujdeset që aktet e miratuara nga kjo mbledhje të mos zbatohen.

MAPL, është e gatshme të ofrojë përkrahje dhe ndihmën e nevojshme, për zbatimin e plotë të obligimeve që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës.

Me respekt,